



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2022:074842

Datë: 25.01.2024

Numri i dokumentit: 05239965

C.nr.302/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, nëpërmjet gjyqtarit Selajdin Gallapeni, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Flutura Rraqi- Kallaba, në çështjen juridike të paditësve A.S nga fshati S, k e S, D.M nga fshati B, k e S, S.S nga P dhe E.K nga fshati G, K e S, të cilët me autorizim i përfaqëson av. Z.B nga F, kundër të paditurës K e S– D e A, të cilin sipas akt emërimit e përfaqëson juristi A. B, me objekt kontesti shpërblimin e inflacionit në pagë, me datë 25.01.2024 mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësve A.S, S.M, S.S, dhe E.K, ashtu që **DETYROHET** e paditura K e S – D e A që në emër të diferencës së papaguar në pagë, referuar normës së inflacionit prej periudhës 14.04.2019 deri me datë 21.11.2022, t’ia paguaj paditësve shumat:

Për paditësin A. S;

Për periudhën prej 14.04.2019 e deri me datë 21.11.2022 shumën e përgjithshme prej **923.62** euro, duke llogaritur shumat sipas viteve dhe shkallës së inflacionit si në vijim:

Për periudhën prej datës 14.04.2019 deri me datë 31.12.2019, për shkallën e inflacionit 2.7 %, shumën prej 105.74 euro;

Për vitin 2020, për shkallën e inflacionit 0.2 %, shumën prej 11,01 euro;

Për vitin 2021, për shkallën e inflacionit 3.4 %, shumën prej 239,16 euro,

Për periudhën pre datës 01.01.2022 deri me datë 21.11.2022, për shkallën e inflacionit 11.6 %, shumën prej 569.71 euro.

Për paditësen D. M;

Për periudhën prej 14.04.2019 e deri me datë 21.11.2022 shumën e përgjithshme prej **923.62** euro, duke llogaritur shumat sipas viteve dhe shkallës së inflacionit si në vijim:

Për periudhën prej datës 14.04.2019 deri me datë 31.12.2019, për shkallën e inflacionit 2.7 %, shumën prej 105.74 euro;

Për vitin 2020, për shkallën e inflacionit 0.2 %, shumën prej 11,01 euro;

Për vitin 2021, për shkallën e inflacionit 3.4 %, shumën prej 239,16 euro,

Për periudhën pre datës 01.01.2022 deri me datë 21.11.2022, për shkallën e inflacionit 11.6 %, shumën prej 569.71 euro.

Për paditësen S. S;

Për periudhën prej 14.04.2019 e deri me datë 21.11.2022 shumën e përgjithshme prej **923.62** euro, duke llogaritur shumat sipas viteve dhe shkallës së inflacionit si në vijim:

Për periudhën prej datës 14.04.2019 deri me datë 31.12.2019, për shkallën e inflacionit 2.7 %, shumën prej 105.74 euro;

Për vitin 2020, për shkallën e inflacionit 0.2 %, shumën prej 11,01 euro;

Për vitin 2021, për shkallën e inflacionit 3.4 %, shumën prej 239,16 euro,

Për periudhën pre datës 01.01.2022 deri me datë 21.11.2022, për shkallën e inflacionit 11.6 %, shumën prej 569.71 euro.

Për paditësin E. K;

Për periudhën prej 14.04.2019 e deri me datë 21.11.2022 shumën e përgjithshme prej **923.62** euro, duke llogaritur shumat sipas viteve dhe shkallës së inflacionit si në vijim:

Për periudhën prej datës 14.04.2019 deri me datë 31.12.2019, për shkallën e inflacionit 2.7 %, shumën prej 105.74 euro;

Për vitin 2020, për shkallën e inflacionit 0.2 %, shumën prej 11,01 euro;

Për vitin 2021, për shkallën e inflacionit 3.4 %, shumën prej 239,16 euro,

Për periudhën pre datës 01.01.2022 deri me datë 21.11.2022, për shkallën e inflacionit 11.6 %, shumën prej 569.71 euro.

Të gjitha këto në shumë totale **3,694.48 € (tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër euro e katërdhjetë e tetë cent)**, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë (14.04.2022), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë për periudhën prej datës 01.03.2019 deri me datë 13.04.2019, gjegjësisht për periudhën 1 muaj e 12 ditë dhe atë për paditësin A.Sshuma prej 17.34 euro; për paditësen D.Mshuma prej 17.34 euro; për paditësen S.Sshuma prej 17.34 euro, për paditësin E.Kshuma prej 17.34 euro , **si e parashkruar.**

III. OBLIGOHET e paditura K e S, që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajë shumën prej 280.00 euro, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Arsyetim

Paditësit, përmes të autorizuarës së tyre, pranë kësaj gjykate me 14.04.2022 kanë parashtruar padi nda të paditurës K së S, D e A, me të cilën kanë kërkuar kompensimin në pagë nga shkalla e inflacionit nga data 01.03.2019 me kamatë ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë në Gjykatë si dhe shpenzimet e procedurës sipas Tarifës së OAK-së në afat prej 7 ditësh nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

I autorizuari i të paditurës, K e S – D e A, pranë kësaj gjykate ka parashtruar përgjigjen në padi, me të cilën ka theksuar se nuk e kundërshton kërkesëpadinë e paditësve lidhur me kompensimin e pagës konform shkallës së inflacionit, marrë për bazë edhe mendimin juridik të Gjykatës Supreme, ndërsa sa i përket pjesës tjetër ta refuzojë mbi bazën e parashkrimit.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitura nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është **pjesërisht e themeltë**, andaj pa shqyrtim të çështjes, i aprovoi kërkesëpaditë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 7 par. 1 i Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”

Në nenin 143 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: “Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore.”

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se të gjithë paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës në Gjimnazin “Jeta e Re” në Suharekë

Këtë fakt, gjykata e vërtetoi përmes kontratave dhe atë:

Për paditësin A.S nga kontrata e punës me nr. të protokollit 161 e datës 01.09.2015 si dhe nga lista e pagës e datës 01.06.2021 ka vërtetuar faktin se i njëjti është në marrëdhënie pune në Gjimnazin “Jeta e re” në Suharekë

Për paditësen D.M nga kontratat e punës me nr. 367 të datës 06.09.2017 si dhe atë me nr.101 të datës 31.01.2020 dhe lista e pagës e datës 01.06.2021, ka vërtetuar faktin se e njëjta është në marrëdhënie pune në Gjimnazin “Jeta e Re” në Suharekë.

Për paditësen S.S nga kontrata e punës me nr. të protokollit 161 e datës 01.09.2015 si dhe nga lista e pagës e datës 01.06.2021 ka vërtetuar faktin se i njëjti është në marrëdhënie pune në Gjimnazin “Jeta e Re” në Suharekë

Për paditësin E.K nga kontrata e punës me nr. të protokollit 28 e datës 01.09.2016 si dhe nga lista e pagës e datës 01.06.2021 ka vërtetuar faktin se i njëjti është në marrëdhënie pune në Gjimnazin “Jeta e Re” në Suharekë

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësve, që t’ia kompensoj diferencën e pa paguar në pagë, referuar normës së inflacionit për vitin 2019 - 2.7 %, për vitin 2020 - 0.2 %, për vitin 2021 - 3.4 % si dhe për vitin 2022- 11.6% deri më datë 21.11.2022 deri kur edhe ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 35, pika 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, që parashihet se “*Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit në bazë të Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës*”.

Sa i përket shkallës së inflacionit nëpër vite, gjykata vendosi si më lartë duke u bazuar konform tabelës së inflacionit të lëshuar nga parashtrësja e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, me numër 01-02-1436, të datës 27.10.2023.

Ndërkaq, gjykata vendosi lidhur me shumën duke llogaritur për periudhën kohore nën marrëdhënie të punës secilin paditës dhe secilin vit, marrë për bazë shkallën e inflacionit, ashtu që: **Për paditësin A. S.**

Për periudhën prej 14.04.2019 e deri me datë 21.11.2022 shumën e përgjithshme prej **923.62** euro, duke llogaritur shumat sipas viteve dhe shkallës së inflacionit si në vijim:

Për periudhën prej datës 14.04.2019 deri me datë 31.12.2019, për shkallën e inflacionit 2.7 %, shumën prej 105.74 euro;

Për vitin 2020, për shkallën e inflacionit 0.2 %, shumën prej 11,01 euro;

Për vitin 2021, për shkallën e inflacionit 3.4 %, shumën prej 239,16 euro,

Për periudhën pre datës 01.01.2022 deri me datë 21.11.2022, për shkallën e inflacionit 11.6 %, shumën prej 569.71 euro.

Për paditësen D. M.

Për periudhën prej 14.04.2019 e deri me datë 21.11.2022 shumën e përgjithshme prej **923.62** euro, duke llogaritur shumat sipas viteve dhe shkallës së inflacionit si në vijim:

Për periudhën prej datës 14.04.2019 deri me datë 31.12.2019, për shkallën e inflacionit 2.7 %, shumën prej 105.74 euro;

Për vitin 2020, për shkallën e inflacionit 0.2 %, shumën prej 11,01 euro;

Për vitin 2021, për shkallën e inflacionit 3.4 %, shumën prej 239,16 euro,

Për periudhën pre datës 01.01.2022 deri me datë 21.11.2022, për shkallën e inflacionit 11.6 %, shumën prej 569.71 euro.

Për paditësen S. S;

Për periudhën prej 14.04.2019 e deri me datë 21.11.2022 shumën e përgjithshme prej **923.62** euro, duke llogaritur shumat sipas viteve dhe shkallës së inflacionit si në vijim:

Për periudhën prej datës 14.04.2019 deri me datë 31.12.2019, për shkallën e inflacionit 2.7 %, shumën prej 105.74 euro;

Për vitin 2020, për shkallën e inflacionit 0.2 %, shumën prej 11,01 euro;

Për vitin 2021, për shkallën e inflacionit 3.4 %, shumën prej 239,16 euro,

Për periudhën pre datës 01.01.2022 deri me datë 21.11.2022, për shkallën e inflacionit 11.6 %, shumën prej 569.71 euro.

Për paditësin E. K;

Për periudhën prej 14.04.2019 e deri me datë 21.11.2022 shumën e përgjithshme prej **923.62** euro, duke llogaritur shumat sipas viteve dhe shkallës së inflacionit si në vijim:

Për periudhën prej datës 14.04.2019 deri me datë 31.12.2019, për shkallën e inflacionit 2.7 %, shumën prej 105.74 euro;

Për vitin 2020, për shkallën e inflacionit 0.2 %, shumën prej 11,01 euro;

Për vitin 2021, për shkallën e inflacionit 3.4 %, shumën prej 239,16 euro,

Për periudhën pre datës 01.01.2022 deri me datë 21.11.2022, për shkallën e inflacionit 11.6 %, shumën prej 569.71 euro.

Ndërsa gjykata vendosi si në pikën e dytë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ku vendosi që pjesa e kërkesëpadisë për periudhën 01.03.2019 deri me datë 13.04.2019, gjegjësisht për periudhën 1 muaj e 12 ditë, te refuzohet si e parashkruar për faktin se sipas Ligjit të Punës, nenit 87 theksohet se, citojmë: *“Të gjitha*

kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.

Ndërkaq në rastin konkret shihet se padia e paditësit është parashtruar pranë kësaj gjykate me datë 14.04.2022, çka do të thotë se kur kthehemi tri vite mbrapa, i bie data 14.04.2019, pra periodha para kësaj të fundit përfshin kohën e parashkrimit.

Gjykata është bazuar në mendimin juridik të miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, të datës 09 tetor 2023 në cilin parashihet se *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit, marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit Sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës”*, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”.

Vendimin mbi kamatën, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë ku për katër paditës vlera është 260 euro si dhe për taksën në padi në shumën 20 euro, në total shuma 280 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi bazuar në nenin 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:074842; Dt. 25.01.2024**

**Bashkëpunëtorja profesionale
Flutura Rraqi- Kallaba**

**Gjyqtari
Selajdin Gallapeni**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2022:074842
Datë: 25.01.2024
Numri i dokumentit: 05239965